



Datë: 01.09.2025
Numër Protokolli: 4491/2025

A.nr.1288/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë, me Kaltrina Avdullahi Prenaj, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1288/2025, të datës 03.07.2025, të parashtruar nga ankuesja A.L-B, kundër organit të punësimit: Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 01.09.2025, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës me numër A.nr.1288/2025, të datës 03.07.2025, të parashtruar nga ankuesja, A.L-B.

A r s y e t i m

Ankuesja, A.L-B, (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja), më datë 03.07.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Njoftimit me numër protokolli 14-111/01-0094265/25, të datës 30.06.2025, lidhur me kandidatët fitues për procedurën e rekrutimit me numër reference RN00017884, për pozitën e punës “*Zyrtar i Lartë për Arkitekturë-Projekt*”, të shpallur nga Komuna e Prishtinës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 16.07.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Prishtinës, ndërsa, kjo e fundit, më datë 29.07.2025, ka përcjellë përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat referuar çështjes në procedurë ankimore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, ka konstatuar se janë përmbushur kushtet për përfundim të procedimit administrativ të filluar sipas ankesës A.nr.1288/2025, **sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se Komuna e Prishtinës, më datë 22.05.2025, ka shpallë Konkursin publik me numër reference RN00017884, për Grupin e Inxhinierisë së Ndërtimit, për pozitën e punës “Zyrtar i Lartë për Arkitekturë-Projekt”, për realizimin e një projekti, me kohëzgjatje për emërim tre (3) vite, për tre (3) vende të lira pune, në Sektorin e Urbanizimit, i hapur për aplikim nga data 22.05.2025 deri më datën 01.06.2025.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs kanë aplikuar gjithsejtë (8) kandidatë, ndër ta edhe ankuesja, e cila e ka kaluar fazën e verifikimit paraprak dhe se e njëjta i është nënshtruar fazës vlerësimit profesional, gjegjësisht intervistës me gojë, duke mbledhur gjithsejtë 67 pikë.

Spektori për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës, më datë 30.06.2025, ka publikuar Njoftimin me numër protokolli 14-111/01-0094265/25, nga i cili njoftim rezulton se si kandidat fitues për procedurën përkatëse janë shpallur kandidatët, A.D me 74 pikë, E.I-S 72.67 pikë dhe B.B me 70.67 pikë.

Ankuesja brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke kundërshtuar procedurën e rekrutimit me numër reference RN00017884, për pozitën përkatëse me pretendimin ankimor se e njëjta posedon përvojën e punës mbi 8-vjeçare në Drejtorinë Urbanizmit

Bazuar në të dhënat e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, rezulton se kandidati B.K, si kandidatë në procedurën e njëjtë, ka parashtruar ankesë me numër A.nr.1296/2025 duke kontestuar procedurën me numër reference RN00017884, ndërsa, Këshilli me Vendimin me numër A.nr.1296/2025, të datës 28.08.2025, ka anuluar Konkursin publik me numër reference RN00017884, për Grupin e Inxhinierisë së Ndërtimit, për pozitën e punës “Zyrtar i Lartë për Arkitekturë-Projekt”, të shpallur nga Komuna e Prishtinës si dhe çdo veprim tjetër që ka rrjedhë nga kjo procedurë e rekrutimit.

Andaj, referuar gjendjes së fakteve si më lartë dhe duke marrë parasysh se objekti i kontestit sipas ankesës A.nr.1288/2025, të datës 03.07.2025, ka të bëjë me procedurën e pranimit për të cilën Këshilli ka vendosur në mënyrë meritore me Vendimin A.nr.1296/2025, të datës 28.08.2025, rrjedhimisht, ka anuluar Njoftimin përfundimtar për kandidatin fitues, si një qëllim i propozuar edhe nga ankuesja në petitumin e ankesës, atëherë, mbi bazën e këtyre rrethanave, e në kuptim të dispozitave të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative më të cilat është përcaktuar se: “Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kot”. Kolegji vlerëson se objekti i ankesës A.nr.1288/2025, është bërë i pamundur për shqyrtim dhe vendosje.

Kështu që, në mbështetje të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1288/2025

Kaltrina Avdullahi Prenaj

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj Demi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses, A.L-B;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Prishtinës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.